



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA

C-II-17-0632-C0001

Parashtruesi i ankesës:

Xh.O., Prishtinë

Kundër:

Pala kundërshtare:

NSH "E.E.", Prishtinë, të cilën e administrojnë **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 16 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit aprovohet si e bazuar.
- II. Urdhërohet Agjencia Kosovare e Privatizimit që këtë ankues ta përfshijë në Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesën nga të ardhurat e 20%-it nga privatizimi i NSH-së "E.E.", në Prishtinë.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Parashtruesi i ankesës ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore NSH "E.E.", në Prishtinë, e cila kishte hyrë në likuidim më 23 dhjetor 2013 në bazë të vendimit të Bordit të AKP-së të datës 31 tetor 2013.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për ndarjen e 20 % të të hyrave të realizuara nga privatizimi/ shitja e ndërmarrjes ishte publikuar si datë e fundit të merret 16 nëntor 2017.

Data e fundit për dorëzimin e ankesave në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare ishte më 9 dhjetor 2017.

Parashtruesi i ankesës Xh.O. më 7 dhjetor 2017 ka dorëzuar ankesë të afatshme në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të listave të punëtorëve.

Në mbështetje të pretendimeve të tij parashtruesi i ankesës si provë ka prezantuar:

- Ankesën e parashtruar më 7 dhjetor 2017
- Kopjen e librezës së punës të noterizuar nr. 19609/75 të datës 18.12.1974
- Certifikata e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga për vitin 2002 (kopje me ngjyra).
- Certifikata e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga për vitin 2003 (kopje me ngjyra).
- Certifikata e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga për vitin 2004 (kopje me ngjyra).
- Certifikata e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga për vitin 2006 (kopje me ngjyra).
- Vendim për pushim pa pagesë nr. 61/1 të datës 18.04.2006 (kopje me ngjyra).

Ankuesi në ankesën e tij konsideron se i ka përmbushur kushtet dhe kriteret ligjore sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve nga ana e Komisionit të AKP-së.

Në mbështetje të pretendimeve të tij se marrëdhënia e punës nuk iu është ndërprerë, ankuesi i referohet nenit 69 të Ligjit për Marrëdhëniet e punës (Gazeta Zyrtare e RS-së nr. 29/90, 42/90 dhe 28/91 i aplikueshëm në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 që është në favor të ankuesit.

Ankuesi në ankesë konsideron se është i diskriminuar nga menaxhmenti i kësaj NSH-je për trajtim jo të barabartë në mesin e punëtorëve që janë përfshirë në këtë listë dhe kërkon nga gjykata që të aplikojë Nenin 8 pika 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit nr. 2004/3.

Më 15 shkurt 2018, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dorëzuar përgjigje në Dhomën e Posaçme përmes së cilës propozon që ankesa e ankuesit Xh.O. të refuzohet si e pabazuar. AKP-ja konsideron se ankuesi nuk i plotëson kriteret ligjore sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13. AKP-ja në përgjigje thekson se ankuesi ka paraqitur kopjen e pavërtetuar të librezës së punës.

AKP-ja thekson se ankuesi nuk ka prezantuar asnjë provë në bazë të Nenit 8, paragrafi 8.1 Ligjit kundër Diskriminimit nr. 2004/3. Sipas AKP-së dokumentet e prezantuara nga parashtruesi i ankesës nuk janë bazë e mjaftueshme për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve për 20%.

Gjithashtu AKP-ja konsideron se parashtruesi i ankesës në kohën e privatizimit nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së, prandaj nuk ka bazë për përfshirjen e tij në listën e punëtorëve me të drejta legjitime, siç parashihet me Rregulloren 2003/13, Neni 10.4.

Më 19 mars 2018 ankuesi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dorëzon përgjigjen e vet kundër përgjigjes së AKP-së.

Në përgjigje ankuesi qëndron pranë pretendimeve të cekura në ankesë dhe kërkon nga Dhoma e Posaçme që të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe përfshirjen e tij në listën përfundimtare të punëtorëve për përfitimin e një pjese e të ardhurave prej 20% nga privatizimi – likuidimi i Ndërmarrjes.

Më 19 gusht 2019 gjyqtarja e Dhomës së Posaçme i dërgon një urdhër AKP-së me të cilin i kërkon që Dhomës së Posaçme t'i dorëzojë kopjen e librit amzë të NSH "E.E.", Prishtinë, lidhur me punëtorin e lartpërmendur.

Më 21 gusht 2019 AKP-ja i përgjigjet urdhrin të Dhomës së Posaçme duke e bashkëngjitur kopjen e librit amzë.

Arsyetimi ligjor:

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

Shqyrtim i përgjithshëm:

Neni 10.1 i Rregullores 2003/13 i rregullon të drejtat e të punësuarve dhe procedurën për përfitimit të 20 % -it nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore.

Neni 10.2 i Rregullores së lartcekur përcakton se si organi përfaqësues i NSH-së në bashkëpunim me Sindikatën e Pavarur përpilon Listën Preliminare dhe të njëjtën ia dërgon Agjencisë që ta shqyrton listën dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje për të gjithë të punësuarit.

Neni 10.3 i Rregullores së lartcekur përcakton se lista zyrtare – përfundimtare e të punësuarve me të drejta legjitime lëshohet nga agjencia me njoftimi për të drejtën në ankesë në pajtim me Nenin 10.6 dhe publikohet në gazetën kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe .

Neni 10.4 i Rregullores së lartcekur përcakton se punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në Listën e Pagave të NSH-së për jo më pakë se tre (3) vite, kjo e drejtë nuk i ndalon edhe punëtorët të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin në regjistrë si punëtor po mos të ishin të diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

Neni 10.6 i Rregullores së lartcekur përcakton se pas paraqitjes së kërkesës nga individë me të drejtë të cenuar ankesa lidhur me listën e punëtorëve me të drejtë legjitime i dërgohet Dhomës së Posaçme për shqyrtim.

Neni 10.6 pika (a) tregon kohën që brenda njëzet (20) ditësh pas shpalljes përfundimtare të listës në media sipas Nenit 10.3.

Vlerësimi i ankesës së ankuesit të cituar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda njëzet (20) ditësh pas shpalljes së Listës përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime, e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftim për të drejtën në ankesë, të publikuar në dy (2) ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavë vijuese, në gazetën kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetën në Serbi dhe Mal të Zi (shih dispozitën e Nenit 10.3 të Rregullores 2003/13).

Ankuesi Xh.O. në Dhomën e Posaçme ka parashtruar ankesën e tij më 7 dhjetor 2017 brenda afatit të paraparë kohor, ashtu siç parashihet me dispozitën e Nenit 10.6 (a) të Rregullores së lartcekur.

Në bazë të shkresave të lëndës gjykata gjen se përveç librezës së hapur të punëtorit të lartpërmendur edhe në librin amzë punëtori figuron të jetë ende aktiv që do të thotë se nuk iu është ndërprerë marrëdhënia e punës.

AKP-ja nuk ka paraqitur kurrfarë provash për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së punëtorit në fjalë.

Ankesa është parashtruar nga ana e ankuesit në përputhje me dispozitat e parapara të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____